



Drejtoria e Arsimit

10 Nr. 174/16  
Datë: 10.03.2016

Në mbështetje nenit 7 dhe 8 të Ligjit mbi Punën të Republikës së Kosovës nr.03/L-212,  
Drejtori i DKA-së, shpall:

**K O N K U R S**

Për vendin e punës:

Vendi i punës: **Vozitës për transportin e fëmijëve me nevoja të veçanta në SHF"Ali Kelmendi"Vushtrri.**

**Lloji i pozitës:** Jo i karrierës

Orari i plotë:40 orë në javë

Kategoria funksionale-Administrativo teknike

Grada-Koeficienti 5

**Qëllimi i vendit të punës:**

Ofrimi i mbështetjes teknike, vozitja e automjetit zyrtar ;

**Përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësiwe;**

- Drejton automjetin sipas urdhrorit të drejtorit, si dhe kujdeset për automjetin me të cilin është i ngarkuar;
- Kujdeset për mirëmbajtjen e tij, larjen, lysterjen, evidentimin e prishjeve etj;
- Përgjigjet për automjetin dhe pajimet në automjet;
- Në fletudhëtim regjistron numrin e kilometrave të kaluara në udhëtim dhe shënimet tjera të cilat në fletudhëtim kërkohen;
- Paraqet mbikëqyrësit të autoparkut çdo defekt dhe dëm të shkaktuar në automjet dhe bën arsyetimin e shpenzimeve të derivateve dhe të kilometrazhit të kaluar;
- Kryen edhe punë tjera sipas urdhërësës së mbikëqyrësit dhe drejtorit të drejtorisë.
- Për punën e vet i përgjigjet mbikëqyrësit drejtorit të drejtorisë.

**Kualifikimi profesional, aftësitë, përgjegjësitë:**

Diplomë e shkollës së mesme

Patentë shoferin-kategoria B

-Përvoja e punës e dy(2) vite.

**Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informacionit publik.**

**-Paraqitja e kërkesave:**

Aplikacionet mund të merren në Zyrën e pranimit ose në faqen e internetit të komunës [www.kk.rks-gov.net/vushtrri](http://www.kk.rks-gov.net/vushtrri) dhe pastaj dorëzohen në Zyrën e pranimit. Aplikacionit duhet t'i bashkëngjisin: **Kopjen e vërtetuar të diplomës, kopjen e letërnjoftimit dhe certifikatën e lindjes, kopjen e vërtetuar të patentë shoferit, certifikatën që nuk është i dënuar dhe nën hetime. Duhet të jetë banor i Republikës së Kosovës.**

Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen. Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhjen e ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor. Për çdo informacion kandidatët mund të drejtohen në Njësinë e personelit



**REPUBLIKA E KOSOVËS**

**KOMUNA VUSHTRRI**

**DREJTORIA E ARSIMIT**

---



10 Nr. 173/16

Datë: 10.03.2016

Mbështetur ne Nenit 5. Pika c, të Ligjit nr. 03/L – 068 për Arsimin në Komunitat e Republikës së Kosovës, dhe Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.06/2015.Drejtoria Komunale e Arsimit në Vushtri shpallë:

### **KONKURS**

#### **Për vendin e lirë të punës**

- **Një Mësues kase me kohë të caktuar në SHF”Mustafë Venhari”Vushtri**

#### **Kushtet për Mësues kase :**

Për këtë vend të punës kërkohet kualifikimi përkatës profesional, sipas UA – 06/2015 (Për normativ mbi kuadrin profesional të arsimit).

Aplikacionet merren në zyrën e arkivit komunal. Aplikacionit i bashkëngjiten dokumentet: Fotokopje të vërtetuara te noteri për kualifikim përkatës, diploma, certifikata e diplomimit jo më e vjetër se gjashtë muaj, ekstrakti i lindjes, letërnjoftimi, vërtetimi për përvojën e punës në arsim – mësimdhënie dhe certifikatat e trajnimeve. Dokumentet e pa kompletuara nuk merren në shqyrtim. Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen. Konkursi mbetet i hapur 15 ditë prej ditës së shpalljes në shtyp.

**Intervistimi i kandidatëve do të mbahet me datën 29.03.2016 në ora 13:30 në sallën e Kuvendit Komunal.**